

VENDIM
Nr.741, datë 5.11.2014

**PËRPËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, KRITEREVE TË PËRDORIMIT DHE
KONTROLLIT TË FONDIT TË POSAÇËM, NË FUNKSION TË VEPRIMTARISË
HETIMORE DHE PROCESIT INFORMATIV TË SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E
BRENDSHME DHE ANKESAT, NË MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka dhe përdor fondin e posaçëm të shpenzimeve, në funksion të veprimtarisë hetimore dhe procesit informativ.

2. Ky fond përdoret në funksion të:

a) veprimtarisë informative dhe në këtë rast përbëhet nga shpenzimet për:

i) shpërblimin e personave, që bashkëpunojnë me shërbimin;
ii) sigurimin, vërtetimin dhe dokumentimin e informacionit;
iii) blerje dhe shërbime të drejtpërdrejta të mjeteve e pajisjeve të përdorimit sekret të punës informative;

iv) marrje me qira të objekteve dhe të mjeteve në funksion të veprimtarisë operacionale;

v) kryerjen e veprimeve informative, operacioneve dhe testit të integritetit.

b) veprimtarisë hetimore dhe në këtë rast përbëhet nga shpenzime për oficerin dhe agentin e Policisë Gjyqësore ose personin e autorizuar, gjatë kryerjes së operacioneve, ku përdoren teknika të posaçme hetimi (përgjime, veprime të simuluar dhe infiltrim).

3. Vlera e fondit të posaçëm është 15 për qind e vlerës së buxhetit vjetor të shërbimit.

4. Kontrolli për shpenzimet e kryera nga fondi i posaçëm ushtrohet jo më pak se një herë në vit nga personat e autorizuar nga ministri i Punëve të Brendshme, të cilët janë të pajisur me certifikatë sigurie të nivelit “Tepër sekret”.

5. Ngarkohet ministri i Punëve të Brendshme për nxjerrjen e udhëzimit përkatës për përcaktimin e procedurave të hollësishme që duhen zbatuar dhe të dokumentacionit që duhet hartuar për përdorimin e këtij fondi.

6. Ngarkohet ministri i Punëve të Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit nr.70/2014.

KRYEMINISTRI
Edi Rama